

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ALBEY SHPK

Sot, më datë 15 gusht 2023, në Tiranë, ortaku i vetëm, Z. **Kujtim Rama**, shtetas shqiptar, lindur më 20.06.1990, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J00620076R, (më poshtë referuar si "**Ortaku i Vetëm**"), vendosi me anë të këtij Akt Themelimi për krijimin dhe themelimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar **ALBEY**.

I. THEMELIMI

Ortaku i Vetëm deklaron themelimin e Shoqërisë **ALBEY**, një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar ("**Shoqëria**"), e cila themelohet në përputhje me ligjin e aplikueshëm tregtar në Republikën e Shqipërisë.

Selia e Shoqërisë është në adresën: "*Rruga 5 Maji*", *Qendra Tregtare Emerald, Kati 1-rë, Tiranë, Shqipëri*.

Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pakufizuar.

II. OBJEKTI

Objekti i Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

- Shitje me pakicë dhe shumicë të mallrave industriale dhe ushqimore, duke përfshirë, por jo vetëm, produkte kancelarie, paisje elektrike, elektronike, kompjuterike, aksesore, kozmetikë, parfume, lodra, lëndë të para, etj.
- Si edhe çdo aktivitet tjetër i cili realizon të ardhura dhe nuk bie në kundërshtim me ligjet Shqiptare në fuqi.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar për përmbushjen e objektit të lartpërmendur, Shoqëria mund:

- (i) të aplikojë dhe të pajiset me një ose të gjitha licencat dhe autorizimet e nevojshme, të kryejë çdo transaksion me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme (përfshirë por pa u kufizuar në blerjen, shitjen, e marrjen dhe dhënien me qira të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme) si edhe aktivitete tregtare, financiare, qira apo hipotekore të cilat mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për përmbushjen e objektit të Shoqërisë dhe që nuk tejkalojnë në masë aktivitetet kryesore, të cituara me sipër;
- (ii) të blejë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, interesa në shoqëri të tjera që kanë objekt (objekti i aktiviteti) të ngjashëm me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj;
- (iii) të kryejë aktivitete publikimi, marketingu e reklamimi;
- (iv) të kryejë aktivitete import - eksporti të mallrave dhe/apo shërbimeve siç do të konsiderohet e nevojshme;
- (v) të kryejë aktivitete për shitjen me pakicë apo shumicë të mallrave, pajisjeve siç do të konsiderohet e përshtatshme;
- (vi) të kryejë çdo aktivitet tjetër që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë.



Shoqëria do të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse dhe standardet më të mira etike, në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

III. STATUTI

Ortaku i Vetëm deklaron se Statuti i Shoqërisë është nënshkruar në mënyrë të rregullt nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë në të njëjtën kohë me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi.

Statuti i Shoqërisë është dokumenti thelbësor, i cili së bashku me çdo marrëveshje tjetër që mund të firmoset në të ardhmen nga Ortaku i Vetëm përcakton: emrin, formën ligjore, kohëzgjatjen, objektin e aktivitetit, kapitalin, administratorin, të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e tij, administrimin financiar dhe kontabël të Shoqërisë, ortakun(ët) e Shoqërisë dhe marrëdhënien mes tyre (nëse aplikohet) dhe kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme.

IV. KAPITALI

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 1000 (njëqind) Lek, i përbërë në 1 (një) kuotë e vetme që zotërohet nga Ortaku i Vetëm.

Çështje të tilla si zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë, si dhe administrimi financiar dhe kontabël i Shoqërisë detajohen në Statutin e Shoqërisë.

V. ORGANET E SHOQËRISË

Organet e Shoqërisë janë:

- (i) Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortaku i Vetëm; dhe
- (ii) Administratori i Shoqërisë.

VI. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme, e cila përbëhet nga Ortaku i Vetëm, është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila merr vendime në lidhje me aktivitetin e saj dhe politikën ekonomike dhe tregtare të saj.

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë të detajuara hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

VII. ADMINISTRATORI

Shoqëria drejtohet nga 1 (një) Administrator, i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë, në marrëdhënie me të tretët dhe është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm tregtar të Shoqërisë me përjashtim të atyre çështjeve që parashikohen në Statut, nga ligji i zbatueshëm apo vendimeve të Ortakut të Vetëm.



Administratori i Shoqërisë është:

- **Z. Kujtim Rama**, shtetas shqiptar, lindur më 20.06.1990, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J00620076R,, i cili ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë para të tretëve me nënshkrimin e tij personal ("**Administratori**").

Administratori emërohet për një afat në detyrë prej 3 (tri) vitesh nga data e regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Me pranimin e emërimit të tij, Administratori njeh se marrëdhënia e tij me Shoqërinë është një marrëdhënie strikte besimi. Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë ka kompetencë që të shkarkojë Administratorin nga detyra e tij në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak.

Të gjitha kompetencat, detyrimet, të drejtat dhe kufizimet e Administratorit të Shoqërisë, si dhe mënyra e përzgjedhjes dhe emërimit, janë të detajuara në mënyrë të hollësishme në Statutin e Shoqërisë.

Ky Akt Themelimi u nënshkrua në 4 (katër) kopje të njëjta dhe origjinale në gjuhën Shqipe.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

Z. Kujtim Rama

Kujtim Rama 